

10909

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 10909 VEND.

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK TE
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ILAR" SH.P.K.

Tirane sot me date 04.05.95 une gjyqtare e Gjykates se rrethit Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur prane kesaj gjykate me:

KERKUES: Arjan Lleshi i biri i Hasanit, i dt.1965 banues ne Tirane, lagja "Ali Demi"pall.161.ap.5; dhe Hasan Lleshi i biri Avdiut,i dt.1934 banues ne Tirane lagja "Ali Demi"pall.161.ap.5

OBJEKTI: Rregjistrimin e shoqerise "ILAR"sh.p.k. ne baze te ligjit nr.7667 date 28.01.1993 dhe ligjit nr.7638 date 19.11.1992

K O N S T A T O V A

Ne baze te kontrates se nenshkruar nga kerkuesi,eshte vendosur krijimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR"sh.p.k. e cila do te kete si objekt te sajine:

Eksport importi dhe shitje me shumice dhe pakice te mallrave ushqimore,industriale, elektroshteciake, aparate dhe perisje elektronike dhe elektrike, hapje pikash turistike dhe lokalesh te ushqimit social, hapje dyqanesh kozmetike dhe bizbuterie, importim, instalim dhe shitje linjash tipografike te llojeve te ndryshme, ngritje shtepi botuese, veprimtari komisionere marketingu e reklame.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100000 leke dhe kohezgjatja e saj 10 vjet. Shoqeria e ka seline ne Tirane ne Lagjen "Ali Demi", pal.161. ap. 5.
Administrator i shoqerise caktohet z.Arjan Lleshi.

Ne mbeshtetje te kerkesave te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per rregjistrin, tregtar", ortaket kane paraqitur dokumentacionin e nevojshem per t'u regjistruar si person juridik dhe ne regjistrin tregtar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 64 te ligjit nr.7667 date 29.01.1993 dhe ligjit nr.7638 date 19.11.1992

V E N D O S A:

Miratimin e kerkeses dhe regjistrimin e shoqerise "ILAR"sh.p.k. si person juridik me afat 10 vjet me kapital themelor 100000 loka me seli ne Tirane, ne lagjen "Ali Demi", pall.161, ap.5.me objekt te veprimtarise:

Eksport importin dhe shitje me shumice dhe pakice te mallrave ushqimore, industriale,elektroshtepiake,aparate dhe paisje elektronike dhe elektrike,hapje pikash turistike dhe lokale te ushqimit social,hapje dyqanesh kozmetike dhe bizhuterie,importim instalim dhe shitje linjash tipografike te llojeve te ndryshme,ngritje shtepi botuese,veprimtari komisionere marketingu dhe reklame.

Administrator i shoqerise eshte z. Arjan Lleshi
Kunder ketij vendimi bejohet ankim ne gjykaten e apelit,
Tirane, me date 24.05.95.

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. I Vendimit

10909/1
6277 VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 10 03.1999, une gjyqtarja e Gjykates se rrethit Tirane, Amila Cefa, pasi shqyrtova kerkesen dhe dokumentet e tjera te paraqitura nga kerkuesi ILIR LLESHI, per Shoqerine "ILAR", shpk,

K o n s t a t o v a ,

ARJAN LLESHI dhe HASAN LLESHI me cilesine e Ortakeve te Shoqerise "ILAR", shpk, person juridik I regjistruar me Vendimin e Gjykates se rrethit Tirane Nr. 10909, date 24.5.1995, me seli ne Tirane me kapital 100.000 leke, ka paraqitur kerkese per depozitim ne regjistrin tregtar, te ndryshimeve ne perberjen e ortakeve te shoqerise, duke u bere ortak I shoqerise dhe Administrator I saj, Z. ILIR LLESHI, I cili merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Shoqerise dhe duke u larguar nga shoqeria ortaku Arjan Lleshi..

Bashkelidhur kerkeses ai ka paraqitur Vendimin e largimit nga shoqeria te ortakut Arjan Lleshi dhe kontraten e shitjes se kuotave te ortakut Arjan Lleshi ortakut tjetër Ilir Lleshi.

Nga shqyrtimi rezulto se kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te nenit 24 dhe dispozitave te tjera te ligjit Nr. 7667, 7638 e 7632,

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses per depozitim ne Regjistrin Tregtar, te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "ILAR" shpk.

Urdherohet zyra e regjistrit Tregtar te beje shenimet perkatese ne Kollonen 4 e 5 dhe ndarjen me vize te kuqe .

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim.

GJYQTARE

Amila Cefa
Cj

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 28/09/.....2002 une gjyqetarja
A. Capo..... e rrethit Tirane pasi u njoha me materialet e paraqitura nga
KERKUESI: Ilir LLESHI Administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
"ILAR" Sh.p.k.Tirane

K O N S T A T O V A :

Se me Vendimin Nr. 10909 date 24.05.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte vendosur rregjistrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " ILAR "sh.p.k.

Gjithashtu me Vendimin Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR"sh.p.k date 17.09.2000 eshte vendosur te shtohet objekti i shoqerise :

-SHKOLLE JO PUBLIKE E MESME.

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura i plotesojne te gjitha kushtet ligjore .

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe ne baze te Nenit 12 te ligjit nr. 7657 date 28.01.1993 "Per Rregjistrimin ne Rregjistrin Tregtar"

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses per depozitim vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Te urdheroj zyren e Regjistrin Tregtare per te depozituar Vendimin Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" Sh.p.k.Tirane date 17.09.2000, duke shtuar objektin e veprimtarise

-SHKOLLE JO PUBLIKE E MESME .

te ndahen regjistrimet nga njeri- tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet perkatese ne kollonen rreshtin

Tirane.me

2002

GJYQTARE

A. Capo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT Tirane
NR 10909/09 Vendimit

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 19/09.....2002 une gjyqetarja
A. Cape..... e rrethit Tirane pasi u njoha me materialet e paraqitura nga
KERKUESI: Ilir LLESHI Administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
"ILAR" Sh.p.k.Tirane

K O N S T A T O V A :

Se me Vendimin Nr. 10909 date 24.05.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte vendosur rregjistrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " ILAR "sh.p.k.

Gjithashtu me Vendimin Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR"sh.p.k date 17.09.2000 eshte vendosur te shtohet objekti i shoqerise :

-Punime te karakterit sekret ne shtypshkonjen "ILAR"

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura i plotesojne te gjitha kushtet ligjore .

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe ne baze te Nenit 12 te ligjit nr. 7657 date 28.01.1993 "Per Rregjistrimin ne Rregjistrin Tregtar"

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses per depozitim vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Te urdheroj zyren e Regjistrin Tregtare per te depozituar Vendimin Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" Sh.p.k.Tirane date 17.09.2000, duke shtuar objektin e veprimtarise

-Punime te karakterit sekret ne shtypshkonjen "ILAR"

te ndahen regjistrimet nga njeri- tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet perkatese ne kollonen rreshtin

Tirane.me

2002

G J Y Q T A R E

REPUBLIKA E SHIQPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 10909/5 Vendimi

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETEM

Ne Tirane, sot, me date 03.05 2005, une Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, M. Kullaq, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Ilir LLESHI administrator i shoqerise "ILAR" shpk dhe,

KONSTATOVA

Se shoqeria "ILAR" shpk, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik me vendimin nr. 10909 date 24.05.1995, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me ortake te shoqerise Z. Hasan Lleshi zoterues i 49% te kapitalit te shoqerise me vlere 49.000 leke dhe Z. Ilir Lleshi zoterues i 51% te kapitalit te shoqerise me vlere 51.000 leke dhe administrator Ilir Lleshi.
Me vendimin nr. 2 date 30.04.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "ILAR" shpk eshte vendosur :

Largimi nga shoqeria i ortakut te shoqerise z. Hasan Lleshi.

Transferimi i 49 % te kuotave te kapitalit te zoteruara nga ortaku Hasan Lleshi, me vlere 49.000 leke z. Ilir Lleshi, nepermjet kontrates se shitjes se kuotave nr. 3854 rep. dhe nr. 404 kol, date 30.04.2005.

Pas nenshkrimimit te kontrates se shitjes se kuotave, ortak i vetem i shoqerise "ILAR" shpk eshte Z. Ilir Lleshi zoterues i 100 % te kapitalit me vlere 100.000 leke.

Administrator i shoqerise eshte Z. Ilir Lleshi.

Administratori i shoqerise Z. Ilir Lleshi kerkon depozitim e vendimit nr. 2 date 30.04.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "ILAR" shpk dhe kontrates se shitjes se kuotave, prane Zyres se Regjistrimit Tregtar dhe pasqyrimin e ndryshimeve ne kollonat perkatese.
Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitim e vendimit nr. 2 date 30.04.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "ILAR" shpk dhe kontrates se shitjes se kuotave nr. 3854 rep. dhe nr. 404 kol, date 30.04.2005, sipas te cilit eshte vendosur :

Largimi nga shoqeria i ortakut te shoqerise z. Hasan Lleshi.

Transferimi i 49 % te kuotave te kapitalit te zoteruara nga ortaku Z. Hasan Lleshi, me vlere 49.000 leke z. Ilir Lleshi, nepermjet kontrates se shitjes se kuotave.

Bazuar ne sa me siper, **ortak i vetem i shoqerise "ILAR" shpk eshte Z. Ilir Lleshi, zoterues i 100 % te kapitalit me vlere 100.000 leke.**

Administrator i shoqerise eshte Ilir Lleshi.

Urdherohet Zyra e Regjistrimit Tregtar te beje ndryshimet ne kollonat perkatese duke i ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
Nr. 10909/i Vendimit
16

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 06.07.2005, unë [Signature], gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit, Z. Ilir Lleshi, me cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë tregtare "ILAR" Sh.p.k., mbi depozitimin e vendimit të Ortakut të Vetëm, datë 17.05.2005.

KONSTATOVA SE:

Shoqëria Tregtare "ILAR" sh.p.k. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr 10909, datë 24.05.1995 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Kërkuarisi, Z. Ilir Lleshi, me cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë tregtare "ILAR" Sh.p.k., kërkon depozitimin e vendimit të Ortakut të Vetëm, datë 17.05.2005, me anën e të cilit është vendosur ndryshimi i nenit 4 të Statutit në këtë mënyrë:

Neni 4

"Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj për një periudhë të pacaktuar kohe."

Vendimi i mësipër i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë ILAR Sh.p.k. është marrë në përputhje me aktet e themelimit të Shoqërisë dhe legjislacionit tregtar në fuqi.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur, për depozitimin e vendimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "ILAR" sh.p.k., datë 17.05.2005, është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar",

V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e vendimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë ILAR Sh.p.k., datë 17.05.2005 për ndryshimin e nenit 4 të Statutit si më sipër.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit në kollonën përkatëse

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE
[Signature]



KONTRATE

Per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" shpk

1. ARJAN LLESHI i biri i HASANIT. i dt 1965 .TIRANE banues..TIRANE lagjia ALI DEMI..pall 161 ap 5.

2.HASAN LLESHI i biri i AVDIUT i dt 1934 banues TIRANE lagjia "ALI DEMI" pallati 161 ap 5

Ne personat e mesiperm me vullnetin tone te lire ne mbeshtetje te nenit 37 te ligjit 7638 dt.19.12.1992" Per shoqerite tregtare" kemi rene dakort qe te krijoje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar,me cilesine e personit juridik privat sipas kushteve te poshteshenuar:

Neni 1

Te krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " ILAR ", sh.p.k e perbere nga ortakët
Arjan Lleshi, Hasan Lleshi

Neni 2

Shoqeria eshte person juridik privat dhe i nenshtrohet legjislacionit shqipetar,ndersa deget, filialet, agjensite qe mund te krijohen jashte shtetit do ti nenshtrohen shtetit ku jane hapur.

Shoqeria do ta zhvilloje veprimtarine e saj ne baze te kesaj kontrate dhe te statutit te miratuar unanimisht nga ortaku i vetem .

Deget, agjensite, filialet e zhvillojne veprimtarine e tyre per llogari te kesaj shoqerie dhe veprojne brenda kufijve e kompetencave te lejuara nga Asambleja .

Neni 3

Shoqeria e ka seline ne qytetin e TIRANES lagjia "Lagjia Ali Demi" pallati 161 ap5

Shoqeria ka te drejte te hape agjensi dege e filiale ne te gjithë teritorin e Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete:

Import-eksport dhe shitje me shumice dhe pakice te mallrave ushqimore industriale e elektro shtepiake; aparate dhe paisje elektronike dhe elektrike; hapje pikash turistike e lokale te ushqimit social; hapje dyqanesh kozmetike e byzhuterie; importim instalim dhe shitje linjash tipografike te llojeve te ndryshme; ngritjesh shtepishe botuese; veprimtari komisionere marketingu e reklame . . .



Neni 5

Shoqeria do te funksionojë dhe do te kryejë veprimtarinë e saj tregtare per nje periudhe mbi 10-vjet, me te drejte ripërteritje te kontrates me kerkese te Asamblese se ortakëve, nje vit para mbarimit te afatit.

Neni 6

Me miratim te ortakëve themelues mund te bashkohen si ortakë ne shoqeri dhe persona te tjere duke derdhur kontribut ne para ose ne natyre sipas mareveshjes me ortakët. Gjithashtu ne shoqeri mund te punesohen puntore dhe specialiste te ndryshem duke lidhur me ta kontrata pune sipas ligjeve ne fuqi.

Neni 7

Kapitali themelor i shoqerise do te jete 100.000 (njqindmije)leke. i derdhur perkatesisht:

Arjan Lleshi 51%

Hasan Lleshi 49%

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me miratimin e Asamblese se Ortakëve duke respektuar kerkesat e neneve 38 dhe 40 te ligjit 7638 "Per shoqerite tregtare "

Neni 8

Kuota nominale e ortakut eshte 1000 leke, kuotat jane te barabarta dhe te pandashme. Cdo kuote prej 1000 leke i takon e drejta e nje vote.

Neni 9

Organet kryesore te shoqerise jane :

- Asambleja e ortakëve,
- Administratori i zgjedhur,
- Eksperti kontabel i autorizuar.

Neni 10

Asambleja e ortakëve themelues zgjedhi si administrator te shoqerise Arjan Lleshi

Neni 11

Asambleja e ortakëve themelues eshte organi sovran i shoqerise.

Vendimet e saj merren meunanimitet ose me shumice votash sipas rasteve te porcakuar ne statut. Vendimet e Asamblese se ortakeve jane te detyrueshme per te ortaket per organet e shoqerise si dhe per te punesuarit ne shoqeri.

Neni 12

Veprimtaria financiare e shoqerise mbyllet ne daten 31.12. te cdo viti. Fitimet neto qe mbeten pas zbritjes se shpenzimeve, detyrimeve fiskale, detyrimeve ndaj te treteve dhe rezerves se domosdoshme, ndahen midis ortakeve ne perpjestim me kontributet e tyre.

Neni 13

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakeve dhe te treteve, te punesuar ne kete shoqeri do te zgjidhen me mirkuptim ,ne te kundert sipas dispozitave ne fuqi te legjislacionit shqiptar.

Neni 14

Dispozita te hollesishme per shoqerine, vendosen ne statutin e saj. Statuti eshte pjese perberese e kesaj kontrate.

Neni 15

Kontrata pasi u lexua nga ortaket themelues u gjet konform vullnetit te tyre dhe u nenshkrua prej tyre , duke mare fuqi ligjore nga data e regjistrimit tesaj ne organet kompetente.

Ortaket Themelues

ARJAN LLESHI

HASAN LLESHI



STATUT

i

Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " ILAR " sh.p.k.

Ne ortaket ARJAN LLESHI ,HASAN LLESHI , identitetin e plote e kemi shkruar ne kontrate, duke qene te pranishem me vullnetin tone te lire, vendosem te krijojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me cilesine e personit juridik privat, sipas kushteve te poshteshenuara te cilat perbejne dhe dispozitat kryesore te kesaj shoqerie.

Kapitulli I

Emri,objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise, vendi i zhvillimit te kesaj veprimtarie,kohezgjatja dhe selia e shoqerise.

Neni 1

Emri i shoqerise eshte" ILAR" sh.p.k.

Neni 2

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete;.
Import eksport dhe shirje me shumice dhe pakice te mallrave ushqimore, industriale, elektro shtepiake, aparate dhe paisje elektronike dhe elektrike, hapje pikash turistike e lokale te ushqimit social, hapje dyqanesh kozmetike dhe bizhuterie, importim instalim dhe shitje linjash tipografike te llojeve te ndryshme, ngritje shtepish botuese, veprimtari komisionere marketingu e reklame.

Neni 3

Vendi kryesor i veprimtarise se shoqerise eshte qyteti i TIRANES.
Selia e shoqerise do te jete ne TIRANE. lagjia "Ali Demi" pallati nr 161 ap 5
Shoqeria ka te drejte te hap dege, agjensi, filiale ne te gjithë rrethet e vendit dhe jashte shtetit.Filialet, deget dhe agjensite jane pjese e shoqerise, i nenshtrohen kontrates dhe statutit te saj,veprojne ne emer dhe per logari te shoqerise brenda kufijeve qe i ka dhene
Asambleja e ortakeve.Deget, agjensite,filialet e ngritura jashte shtetit i nenshtrohen ligjit te vendit ku funksionojne.

Neni 4

Shoqeria do te ushteroje veprimtarine e saj per nje periudhe 10-vjecare, duke filluar afati nga data e regjistrimit, ne Gjykate me te drejte ripertesitje te veprimtarise se shoqerise me kerkesen e Asamblese se ortakeve 1vit para mbarimit te afatit te kontrates.

Neni 5



Shoqeria do ta ushtroje veprimtarine e saj si person juridik privat, pas miratimit nga organet shteterore kompetente.

Kapitulli II

Kapitali themeltar dhe pergjegjesia e shoqerise.

Neni 6

Kapital themeltar i shoqerise " ILAR" sh.p.k. eshte 100.000(katerqindemije)leke, kapital ne para i derdhur nga ortaket themelues: ARJAN LLESHI ne masen 51%, HASAN LLESHI ne masen 49%.

Kapitali ndahet ne pjese te barabarta vlera nominale e te cilave eshte 1000(njemije)leke. Cdo kuote prej 1000 leke, i takon e drejta e nje vote.

Neni 7

Kapitali themeltar ne para, do te derdhet brenda 8 diteve, nga dita e themelimit te shoqerisene Banken Shqiptare duke celur llogari rrjedhese prane kesaj Banke.

Neni 8

Kapitali themeltar mund te zmadhohet me vendim te Asamblese se ortakeve, duke respektuar kerkesat e neneve 38,40,62 te ligjit Nr.7683 "Per shoqerite tregtare".

Neni 9

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj ndaj te treteve deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ka Shteti si dhe personat e tjere juridik qe administrojne pasurine e tij.

Neni 10

Pjeset e kapitalit themeltar mund te shiten duke vene ne dijeni ortaket per kushtet e shitjes. Shoqeria ka te drejten e parablerjes brenda 30 diteve nga data e komunikimit. Pas ketij afati pjeset e kapitalit themeltar mund tu shiten te treteve duke e njoftuar shoqerine per emrin e blesit, per kushtet e shitjes te cilat nuk mund te jene me te mira se ato te ofruara ortakeve.

Kapitulli III



Administrimi i shoqerise

Neni 11

Organet kryesore te shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve,
- Administratori i zgjedhur,
- Eksperti kontabel i autorizuar

Neni 12

Asambleja e ortakeve eshte organi sovran i shoqerise dhe perbehet nga tre ortake, me te drejte vote te barabarte, ne perpjestim me kuotat e derdhura ne kapitalin fillestar.

Asambleja e ortakeve vendos me shumice votash per keto ceshtje:

- Zgjedhjen e administratorit dhe te ekspertit kontabel te autorizuar.
- Ndryshimet ne statut
- Rritjen ose pakesimin e kapitalit themeltar
- Hapjen e degeve, agjensive ose filialeve brenda ose jashte shtetit
- Miratimin e raportit te administratorit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga ekeparti kontabel i autorizuar
- Miratimin e bilancit dhe ndarjen e fitimit
- Zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise si dhe prishjen e saj para afatit

Asambleja zhvillon mbledhje te zakonshme dhe te jashtezakonshme, sa here qe e paraqet nevoja si dhe me kerkesen e cdo ortaku themelues.

Neni 13

Asambleja e ortakeve mblidhet te pakten nje here ne vit. Thirja e Asamblese se ortakeve behet me njoftim me shkrim, duke u shprehur qarte per rendin e dites te pakten 15 dite perpara, lajmerim i cili behet me leter rekomande. Cdo ortake mund te perfaqesohet nga nje ortake tjeter, me ane te prokures.

Per cdo mbledhje te Asamblese mbahet nje procesverbal, nga sekretari i caktuar nga Asambleja e ortakeve. Ne rast se Asambleja e shikon me vend procesverballi qe mbahet dhe vendimi qe merret, redaktohen nga nje noter ose avokat i zgjedhur.

Kapitulli IV

Drejtimi dhe organizimi i Shoqerise

Neni 14

Drejtimi i problemeve te Shoqerise behet nga administratori i zgjedhur nga ortakët themelues, i cili perfaqeson shoqerine dhe pergjigjet individualisht si ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit dhe te kontrates si dhe per faje gjate administrimit te shoqerise.



Neni 15

Asambleja e ortakeve themelues te shoqerise zgjodhi si Administrator ARJAN LLESHI,

duke i dhene keto kompetenca kryesore;

-Drejton veprimtarine ekonomike te shoqerise ne perputhje te plote me ligjet, kontraten dhe statutin e shoqerise,

-Merr masat per mbledhjet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te Asamblese, sa here qe lind nevoja ose kerkon njeri prej ortakeve themelues,

-Organizon punen duke aktivizuar ekspert te fushave te ndryshme per rritjen e pasurise se shoqerise. Per kete ka te drejte te lidh marreveshje me personat juridik ose fizik shqiptar ose te huaj, per blerje, shitje, ndermjetesim komosioneri ose operacione te tjera tregtare dhe financiare.

-Nenshkruan kontrata ne emer te shoqerise dhe merr masa per plotesimin e afateve te tyre,

-Perfaqeson Shoqerine ne Gjykate, Arbitrazh ne Dhomen e Tregtise dhe Industrise si dhe ne organe te tjera shtetore.

-Organizon konkurse per punesimin e specialisteve te jashtem te shoqerise, duke caktuar kushtet kryesore te kontrates se punes.

-Kontrollon veprimtarine ekonomike financiare te shoqerise, duke aktivizuar dhe specialiste dhe kur dalin probleme ia parashtron Asamblese se ortakeve duke propozuar dhe masat qe mund te merren.

-Ndjek dhe pergjigjet per detyrimet fiskale dhe detyrimet e tjera te shoqerise, kryen te gjitha veprimet qe kane te bejne me garancite pasurore si pengu, kapari, ipoteka etj.

-Urdheron kryerjen e te gjitha veprimeve financiare dhe bankare qe kane te bejne me qarkullimin civil te pasurise se shoqerise, duke i nenshkruar vete dokumentat.

Neni 16

Ne pajtim me nenin 65 te ligjit "Per shoqerite tregtare", Asambleja e ortakeve do te emeruje ekspertin kontabel te autorizuar i cili detyrimisht do te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se ortakeve ose te konsultimeve.

Raporti i administratorit, inventaret, llogarite vjetore te hartuara nga administratori vihen ne dispozicion te ekspertit kontabel, te pakten 40 dite para mbledhjes se Asamblese.

Kapitulli V

Bilanci dhe te ardhurat

Neni 17

Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise mbyllen ne 31 dhjetor te cdo viti, pervec te ardhurave te vecanta.

Ne fund te cdo periudhe behet bilanci dhe nxirret rezultati ekonomik, fitime humbje sipas ligjit.

10909/1
6277

KERKESE

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

KERKUES : Ilir LLESHI, I biri I Hasanit, lindur me 1959, banues ne Tirane madhor me zotesi juridike per te vepruar me nr. cert.lindje 87/13.

OBJEKTI : Ndryshime ne statutin e shoqerise .

Une Ilir Lleshi sipas dokumenteve bashkengjitur , jam ortak I me 51% te kapitalit dhe administrator ne Shoqerine " ILAR " sh.pk., shoqeri e regjistruar ne Gjykate me vendimin nr .10909, date 24.05.1995.

Ortaku Arjan Lleshi me 51% te kapitalit , ka vendosur te largohet nga shoqeria dhe kuotat e tij, sipas kontrates se shitjes bashkengjitur, mi ka shitur mua kundrejt vleres 51.000 leke te reja. Arjan Lleshi largohet dhe si administrator dhe, administrator I shoqerise do te jem une Ortaku I ri ILIR LLESHI .

Kerkoj nga ana juaj si Gjykate qe te vendoset qe te gjitha keto ndryshime te pasqyrohen ne regjistrin tregtar ku eshte regjistruar shoqeria jone.

ADMINISTRATORI

ILIR LLESHI

Ilir Lleshi
[Signature]

Be sic fjaltohet
10.03.99
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR 1470 REP

VERTETIM

Sot ne daten 25.02.1999 (nentedhjete e nente) perpara meje Mimoza Sadushi, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. Duresit, Pall. 11, u paraqit personalisht administratori I shoqerise " ILAR " sh.p.k., Z. ILIR LLESHI, I biri I Hasanit, lindur me 1959, banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, me dokument identifikimi nr. 87/13, i cili nenshkroi rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
MIMOZA SADUSHI
NOTERIA
TEL = 348-55

The block contains several notary stamps and seals. At the top is a circular seal of the Ministry of Justice of the Republic of Albania. Below it is a rectangular stamp with the text 'NOTERIA TIRANE' and 'TEL = 348-55'. To the right is another circular seal. In the foreground, there is a 100 Lekë postage stamp from the Republic of Albania, dated 'JULLET 1999', featuring a figure and the text 'POSTIMIRISHT'.

KONTRATE SHITJE
(Kuota)

Sot me date 25.02.1999 ne palet e poshteshenuara, lidhim kete kontrate shitje:

SHITES : ARJAN LLESHI, i biri Hasanit, lindur me 1965, banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, ortak i Shoqerise "ILAR" shpk, per identitetin e te cilit u sigurova nga cert.lindje 87/13.

BLERES : ILIR LLESHI, i biri i Hasanit, lindur me 1959, banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, me cert.lindje 87/13.

ME OBJEKT : Trasferim nepermjet shitjes te kuotave te Shoqerise "ILAR" shpk, e regjistruar ne gjykate me vendimin nr. 10909, date 24.05.1995, me kapital prej 100.000 leke.

Pala shitesese eshte ortak me 51 %, baras me vleften 51.000 leke (pesedhjetenjemije) te kuotave te Shoqerise "ILAR" shpk.

Keto kuota (51% ose 51000 leke) Arjan Lleshi deklaron se ja shet blesesit Ilir Lleshi.

Pala blerese z. Ilir Lleshi deklaron se eshte dakort te bleje kuotat e mesiperme 51% ose 51.000 leke duke i likujduar menjehere.

Me noterimin e kontrates shitesesi Arjan Lleshi largohet nga shoqeria dhe ortak me 51 % te kuotave ose 51.000 leke, behet z. ILIR LLESHI.

Kontrata nenshkruhet nga ne palet ne perputhje me ligjin.


PALA SHITESE

PALA BLERESE

ARJAN LLESHI

ILIR LLESHI

Arjan Lleshi


Ilir Lleshi


V E N D I M

I ORTAKEVE TE SHOQERISE

Nr. 1, date 25.02.1999

Sot ne daten 25.02.1999 ne ortaket e shoqerise "ILAR" sh.p.k, ARJAN LLESHI dhe HASAN LLESHI, shoqeri e regjistruar ne Gjykate me vendimin nr.10909, date 24.05.1995, ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" si dhe duke patur parasysh nenet e statutit te themelimit te saj, mori ne shqyrtim kerkesen e ortakut Arjan Lleshi, per ndryshime ne statut te shoqerise dhe konkretisht trasferim nepermjet te shitjes se kuotave te tij ortakut te ri Ilir Lleshi.

Ne perfundim te mbledhjes ne ortaket,

V E N D O S E M

- 1- Te largohet nga shoqeria ortaku Arjan Lleshi.
2. Largimi I z. Arjan Lleshi edhe si Administrator i shoqerise.
3. Shitjen e kuotave 51 % ose 51.000 leke te ortakut Ilir Lleshi.


Ortake te shoqerise behen Ilir Lleshi me 51% te kuotave ose 51.000 leke dhe Hasan Lleshi me 49% te kuotave ose 49.000 leke dhe Administrator i saj behet ortaku I ri ILIR LLESHI.

3. T'i behet kerkese gjykates se Rrethit Tirane per te bere ndryshimet ne regjistrin tregtar te saj nga Ortaku Ilir Lleshi.

O R T A K E T


ARJAN LLESHI

ILIR LLESHI



10909/4
20/09/2002

S A Capa
20 09 2002
Shani

K E R K E S E

KERKUESI : Ilir LLESHI Administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" Sh.p.k.Tirane
OBJEKTI :
Depozitim e Vendimit Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise " ILAR" sh.p.k.date 17.09.2002

**GJYKATES SE RRETHIT
T I R A N E**

Me Vendimin Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR "sh.p.k. (e njohur si person juridik me Vendimin Nr. 10909 date 24.05.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane) date 17.09.2000 eshte vendosur te shtohet objekti I shoqerise :

-Punime te karakterit sekret ne shtypshkonjen "ILAR"

Paraqes dokumentat prane Gjykates se Rrethit Tirane per te bere te mundur depozitim ne zyren e Rregjistrir Tregtar te Vendimit Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR "sh.p.k. date 17.09.2002

**K E R K U E S I
ILIR LLESHI**

Administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR"SH.P.K.TIRANE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
T I R A N E
Nr.....4585.....Rep**

09/02 Imp EXP
ILAR SH
TIRANE ALBANIA

V E R T E T I M

Sot me date 19.09.2002, ne Zyren e Noterise Tirane, u paraqit personalisht para meje Z.ILIR LLESHI, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i cili me deklaroi se Kerkesa e mesiperme eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe une noterja e vertetova ate ne baze te ligjit .



Vendim nr 2 I Asamblese se Ortakeve te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" Sh.p.k.Tirane

Sot ne date 17.09.2002 ne ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" sh.p.k. (e njohur si person juridik me Vendimin Nr. 10909 date 24.05.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane) , Hasan Lleshi dhe Ilir Lleshi , ne mbledhjen e shoqerise , duke marre parasysh edhe aktivitetin e sukseshem te saj kemi vendosur te shtojme objektin e veprimtarise se shoqerise :


-Punime te karakterit sekret ne shtypshkonjen "ILAR"

Paraqesim dokumentat prane Gjykates se Rrethit Tirane per te bere te mundur depozitimimin ne zyren e Rregjistrimit Tregtar te Vendimit Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" sh.p.k. date 17.09.2002

ORTAKET

e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
"ILAR"SH.P.K.TIRANE

ILIR LLESHI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
TIRANE
Nr.....Rep

HASAN LLESHI



V E R T E T I M

Sot me date 17.09.2002, ne Zyren e Noterise Tirane, u paraqiten personalisht para meje Z.ILIR LLESHI dhe Z. HASAN LLESHI , madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, te cilet me deklaruan se vendimi I mesiperm eshte sipas vullnetit te tyre te lire e te plote dhe une noterja e vertetova ate ne baze te ligjit .



10909/5

KERKESE

S B Mucos
03 MA 03 05 05
[Signature]

KERKUES : Ilir LLESHI, shtetas shqiptar, madhor me zotesi per te
Vepruar, administrator i shoqerise "ILAR" shpk

OBJEKTI : Depozitim e vendimit nr. 2 date 30.04.2005 te Asamblese se
Ortakeve te shoqerise "ILAR" shpk.

Baza Ligjore : Ligji 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar " dhe ligjit 7638
date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " .

DREJTUAR
GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Shoqeria "ILAR" shpk, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik me
vendimin nr. 10909, date 24.05.1995, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me
ortake Hasan Lleshi dhe Ilir Lleshi.

Me vendimin nr. 2 date 30.04.2005 te Asamblese se ortakeve te shoqerise
"ILAR" shpk eshte vendosur :

Transferimi i 49 % te kuotave te kapitalit te zoteruara nga ortaku Z. Hasan
Lleshi, me vlere 49.000 leke z. Ilir Lleshi, nepermjet kontrates se shitjes se
kuotave .

Pas nenshkrimit te vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise dhe kontrates
se shitjes se kuotave, ortak i vetem i shoqerise "ILAR" shpk eshte Ilir LLESHI.
zoteruese e 100 % te kapitalit me vlere 100.000 leke.

Administrator i shoqerise eshte Ilir LLESHI.

Kerkojme depozitim e vendimit nr. 2, date 30.04.2005 te Asamblese se
Ortakeve te shoqerise "ILAR" shpk, prane Zyres se Regjistrimit Tregtar duke bere
ndryshimet ne kollonat perkatese .

ADMINISTRATOR

Ilir LLESHI

[Stamp: 04/05/05, TIRANE]

Vendimi Nr 2 dt
30.04.05 i
A. Ollas keve
Kontrate shitje
Nr 3854/404
dt 29.04.05

SHOQERIA
“ I L A R “ shpk

VENDIM
Nr.2 date 30.04.2005
i ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE
TË SHOQERISE “ ILAR “ shpk

Ne Tirane sot me date 30.04.2005 ne seline e shoqerise “ILAR“ shpk, u zhvillua mbledhja e Asamblese se Ortakeve të shoqerise me rend dite :

Transferimin e 49 % të kapitalit të shoqerise.

Pas shqyrtimit Ortaku i Vetem

V E N D O S I

Largimin nga shoqeria te ortakut te vetem z. Hasan LLESHI.

Transferimin e 49 % te kuotave te kapitalit te zoteruara nga ortakut Hasan Lleshi, me vlere 49.000 leke z. Ilir Lleshi, nepermjet kontrates se shitjes se kuotave .

Pas nenshkimit te ketij vendimi dhe kontrates se shitjes se kuotave, ortak i vetem i shoqerise “ILAR “ shpk mbetet Z. Ilir Lleshi zoterues i 100 % të kapitalit me vlere 100.000 leke.

Administrator i shoqerise eshte Z. Ilir Lleshi.

Ngarkohet administratori i shoqerise qe të ndjeke procedurat ligjore per depozitimin e dokumentacionit të nevojshem prane zyres se regjistrimit tregtar.

ORTAKET E SHOQERISE “ ILAR “

ILIR LLESHI



HASAN LLESHI



10909/6

z: Blerime Muca
06.07.2005
KORIK 2005



KËRKESË

KËRKUES: Shoqëria Tregtare "ILAR" sh.p.k., përfaqësuar nga administratori i Shoqërisë Z. Ilir Lleshi, i biri i Hasanit, i datëlindjes 10.02.1959, lindur në dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga "Myslym Shyri", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

OBJEKTI: Depozitimi i vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë ILAR Sh.p.k., të datës 17.05.2005, për një ndryshim në Statutin e Shoqërisë.

PËRPARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

I nderuar Zoti Kryetar,

*Be depozi te kete
dt. 06.07.05*

Shoqëria Tregtare "ILAR" sh.p.k. është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.10909, datë 24.05.1995 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit.

Prof.

Me cilësinë e administratorit të shoqërisë sipas vendimit të datës 17.05.2005, paraqes këtë kërkesë përpara kësaj gjykate për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të shoqërisë "ILAR" të datës 17.05.2005. Me anë të këtij vendimi, ortaku i vetëm i shoqërisë ka vendosur të ndryshojë nenin 4 të Statutit, për sa i përket afatit të veprimitarisë të shoqërisë.

*Blendi M. Ollaku
dt 17.5.2005*

Ky vendim është marrë në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të shoqërisë. Për këto arsye kërkojmë depozitimin e vendimit të mësipërm të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë ILAR Sh.p.k., datë 17.05.2005.

KËRKUES

ADMINISTRATORI

Ilir LLESHI

Ilir Lleshi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 6675 Rep.

Nr. 561 Kol.

VËRTETIM

Sot, më datë 17/5/2005, para meje Noterit Agim ROBO, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Z. Ilir Lleshi, i biri i Hasanit, i datëlindjes 10.02.1959, lindur në dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga "Myslym Shyri", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur personalisht prej meje, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER

Agim ROBO



SHOQËRIA TREGTARE
"ILAR" SH.P.K.

VENDIM
I
ASAMBLESE SË ORTAKUT
TË VETËM



Më datë 17.05.2005, në Selinë e shoqërisë tregtare "ILAR" sh.p.k. në Tiranë, u mbajt mbledhja e Ortakut të Vetëm, sipas rregullave ligjore në fuqi dhe me rendin e ditës si më poshtë:

1. Për një ndryshim në Statut.
2. Të ndryshme.

Asambleja e Ortakut të vetëm Z. Ilir Lleshi, i cili përfaqëson 100% të kapitalit, proçedoi me shqyrtimin e rendit të ditës. Asambleja konstatoi se ecuria e aktivitetit të shoqërisë për gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të tij ka patur një zhvillim, i cili justifikon vazhdimësinë e tij. Për këtë arsye kërkohet ndryshimi i dispozitës përkatëse të statutit për sa i përket afatit të shoqërisë.

Kështu ortaku i vetëm i shoqërisë "ILAR" Sh.p.k., në mbështetje me legjislacionin tregtar në fuqi, vendosi të ndryshojnë nenin 4 të Statutit, si më poshtë vijon:

Neni 4

"Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj për një periudhë të pacaktuar kohe."

Asambleja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, pas konsultimeve me aktet e themelimit dhe legjislacionin tregtar në fuqi,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë nenin 4 të Statutit si më poshtë vijon;
"Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj për një periudhë të pacaktuar kohe."
2. Të ngarkojë Administratorin Z. Ilir Lleshi me ndjekjen e proçedurave të depozitimit të këtij vendimi në Gjykatë;

ORTAKU I VETËM

Ilir LLESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 6674 Rep.

Nr. 560 Kol.

VËRTETIM

Sot, më datë 17/5/2005, para meje Noterit Agim ROBO, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Z. Ilir Lleshi, i biri i Hasanit, i datëlindjes 10.02.1959, lindur në dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga "Myslym Shyri", person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur personalisht prej meje, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTER

Agim ROBO



KËRKESË

KËRKUES: Shoqëria ILAR sh.p.k. e përfaqësuar nga Av. Envi Hicka.

OBJEKTI: Vënia në dispozicion e vendimeve tregtare të shoqërisë ILAR sh.p.k. nr. 10909, datë 24.05.1995.

DREJTUAR: Zyrës së Regjistrimit Tregtar, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Të nderuar zotërinj,

Kërkojmë, që me cilësinë e avokatëve të Shoqërisë tregtare ILAR sh.p.k të pajisemi me vendimet tregtare në lidhje me shoqërinë ILAR në funksion të një gjykimi civil që zhvillohet aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe që ndiqet prej nesh në emër dhe për llogari të kësaj shoqërie.

Bashkëngjitur me këtë kërkesë ju paraqesim edhe aktin e përfaqësimit të lëshuar nga shoqëria ILAR sh.p.k.

KËRKUESI
Shoqëria "ILAR" sh.p.k.

Përfaqësuar nga,
Av. Envi HICKA



zyrës së Regjistrimit
- Sh. Jorgji
Mei Hicka
me pyetje
P.Hicka

SHOQËRIA TREGTARE
"ILAR" Sh.p.k.
TIRANË

AUTORIZIM

Me anën e të cilit autorizojmë Av. Artan Hajdari dhe Av. Envi Hicka për të përfaqësuar shoqërinë tonë në çështjen civile të ngritur përpara Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt detyrimin e palës së paditur për të përmbushur detyrimin kontraktor dhe shpërblimin e dëmit.


Kjo çështje ka si paditës shoqërinë ILAR sh.p.k. dhe të paditur shoqërinë "Botime Periodike Spektër" sh.a.

Ky autorizimin lëshohet me qëllim përfaqësimit e shoqërisë sonë për gjykimin e çështjes si më sipër përpara Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në të gjitha shkallët e tjera të gjykimit deri në përfundim të tij dhe përpara çdo organi përmbarimor.

Av. Artan Hajdari dhe Av. Envi Hicka kanë të drejtë, që të dy së bashku ose secili veçmas të përpilojnë dhe firmosin dokumentet, të bëjnë çdo lloj prapësimi në lidhje me gjykimin, si dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet juridike dhe proceduriale, që ata i konsiderojnë të nevojshme për zgjidhjen e çështjes në favor të shoqërisë "ILAR." sh.p.k.

ADMINISTRATORI I SHOQËRISË
"ILAR" sh.p.k.

Ilir Lleshi



Tiranë më 05.04.2004

Lenda: Kerkese per rregjistrimin e shoqerise me pergjrgjesi te kufizuar "I L I A R" sh.p.k



Gjykates se rrethit

10909
Tirane



Ne ortaket Arjan Lleshi dhe Hasan Lleshi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "I L I A R" sh.p.k kerkojme ne baze te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 rregjistrimin e kesaj shoqerie me seli ne Tirane, lagjia "Ali Demi", pall 161, ap 5 me kapital themeltar 100.000 leke me administrator Arjan Lleshin me afat 10 vjet me objekt veprimtarie: Import eksport dhe shitje me shumice dhe pakice te mallrave ushqimore, industriale, elektro shtepiake, aparate dhe pajisje elektronike dhe elektrike, hapje pikash turistike e lokale te ushqimit social, hapje dyqanesh kozmetike dhe bizhuterie, importim instalim dhe shitje linjash tipografike te llojeve te ndryshme, ngritje shtepish botuese, veprimtari komisionere marketingu e reklame. Per kete ne baze te ligjit nr 7676 date 28.01.1993 kemi hartuar rregullisht kontraten dhe statutin e shoqerise "I L I A R" sh.p.k.

Kerkuasa K E R K U E S

Arjan Lleshi
HA. SON 16.05.95
ARJAN LLESHI

HASAN LLESHI

Republika e Shqiperise
NOTERIA

Nr. 6863 Rep.
Nr. 1506 Kol.

60 uep-2405-95
VERTETIM

Sot me daten 22.05.95 para meje noter ne noterine e Tiranes u paraqiten personalisht Agron Lleshi dhe Hasan Lleshi madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoffimet te cilet me deklaruan se jashte zyrave te noterise kane hartuar kerkesen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "I L I A R" sh.p.k dhe duke qene ortake te saj e nenshkruan ate para meje.

Une noteri e vertetoj rregullisht.



Noter

MIMOZA SADUSHI
NOTERE
Adresa: Pallatet e Lanës, 1
Tel. e Fax - - 355 42 23866
TIRANË - ALBANIA

10909/3
20/09/2002

3 A Cezaro
20 09 2002
[Signature]

K E R K E S E

KERKUESI : Ilir LLESHI Administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" Sh.p.k.Tirane

OBJEKTI :

Depozitimin e Vendimit Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise " ILAR" sh.p.k.date 17.09.2002

**GJYKATES SE RRETHIT
T I R A N E**

Me Vendimin Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR "sh.p.k. (e njohur si person juridik me Vendimin Nr. 10909 date 24.05.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane) date 17.09.2000 eshte vendosur te shtohet objekti I shoqerise :

-SHKOLLE JO PUBLIKE E MESME

Paraqes dokumentat prane Gjykates se Rrethit Tirane per te bere te mundur depozitimin ne zyren e Rregjistrimit Tregtar te Vendimit Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR "sh.p.k. date 17.09.2002

**K E R K U E S I
I L I R L L E S H I**

Administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR"SH.P.K.TIRANE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
T I R A N E
Nr.....4587.....Rep**

[Signature]
09/09/2002 Imp Exp
ILAR
TIRANE ALBANIA

V E R T E T I M

Sot me date 19.09.2002, ne Zyren e Noterise Tirane, u paraqit personalisht para meje Z.ILIR LLESHI, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i cili me deklaroi se Kerkesa e mesiperme eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe une noterja e vertetova ate ne baze te ligjit .



Vendim nr 2 I Asamblese se Ortakeve te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" Sh.p.k.Tirane

Sot ne date 17.09.2002 ne ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" sh.p.k. (e njohur si person juridik me Vendimin Nr. 10909 date 24.05.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane) , Hasan Lleshi dhe Ilir Lleshi , ne mbledhjen e shoqerise , duke marre parasysh edhe aktivitetin e sukseshem te saj kemi vendosur te shtojme objektin e veprimtarise se shoqerise :


-SHKOLLE JO PUBLIKE E MESME .

Paraqesim dokumentat prane Gjykates se Rrethit Tirane per te bere te mundur depozitimimin ne zyren e Rregjistrimit Tregtar te Vendimit Nr.2 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ILAR" sh.p.k. date 17.09.2002

ORTAKET

e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
"ILAR"SH.P.K.TIRANE

ILIR LLESHI



09/02

HASAN LLESHI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
TIRANE
Nr.....4588.....Rep



VERTETIM

Sot me date 19.09.2002, ne Zyren e Noterise Tirane, u paraqiten personalisht para meje Z.ILIR LLESHI dhe Z. HASAN LLESHI , madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, te cilet me deklaruan se vendimi I mesiperem eshte sipas vullnetit te tyre te lire e te plote dhe une noterja e vertetova ate ne baze te ligjit .

NOTERE

